



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 15 Prot.

Rrogozhinë, më 25.02.2026

VENDIM

Nr. 13 , datë 25.02.2026

**PËR PRANIMIN E TË MOSHUARËS ZNJ. DRITA SHIRA NË QENDRËN E
PËRKUJDESIT REZIDENCIAL PËR TË MOSHUAR “MISSIONARIES OF CHARITY”
(MOTRAT E NËNË TEREZËS) TIRANË**

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e radhës me datë 25.02.2026 analizoi dhe diskutoi në lidhje me projekt-vendimin e ardhur nga Kryetari i Bashkisë, me shkresë Nr.817.Prot datë 24.02.2026 “Për pranimin e të moshuarës znj. Drita Shira në qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar ‘Missionaries of Charity’ (motrat e Nënë Terezës) Tiranë”, si dhe Relacionin shpjegues për këtë projektvendim me Nr.817/1.Prot datë 24.02.2026.

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, datë. 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” , i ndryshuar, të Ligjit Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzimet personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” Kreu III Pika 13 A pika 14; pika 17; pika 18; pika 23, a ; pika 24; Kreu IV “Kriteret e përfitimit të shërbimit dhe përmbajtja e dosjes pika 58, c, pika 59, si dhe bazuar në formularin e verifikimit të gjendjes sociale ekonomike të të moshuarës , me propozim të Zëvendëskryetarit të Bashkisë ushtrues i detyrës së Kryetarit, me 12 (dymbëdhjetë) vota pro, 0 (zero) vota kundër, 0 (zero) vota abstenim, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

1. Pranimin e të moshuarës znj. Drita Shira në qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar “Missionaries of Charity” (motrat e Nënë Terezës) Tiranë, me nr . ID. F05921014C duke i ofruar :
 - Strehim.
 - Ushqim.
 - Përkujdesje Shëndetësore.
 - Përkujdesje Social-Psikologjike.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Mbrojtjes dhe Kujdesit Social pranë Bashkisë Rrogozhinë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA RROGOZHINË
KËSHILLI BASHKIAK

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

ZËVENDËSKRUEJTAR I KËSHILLIT

ERIND TOSKU

